

Analiza vjetore 2022, për Departamentin e Auditimit të Performancës

Në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës, më datë 09.02.2023 u mbajt analiza vjetore e veprimtarisë të Departamentit të Auditimit të Performancës. Në këtë analizë morën pjesë audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, studentë dhe pedagogë nga Universiteti Politeknik i Tiranës.

Analiza e cila u realizua sipas një programi të përcaktuar, në zbatim të Urdhrit Nr. 11 datë 24.01.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku u referua për veprimtarinë Departamenti i Auditimit të Performancës gjatë **vitit** 2022 në drejtim të:

- Realizimit të treguesve; analizimit zbatimi i rekomandimeve në auditimet e mëparshme; rritjes së bashkëpunimeve me sai-e homologe dhe botën akademike; u identifikuan dobësitë si dhe u referua për objektivat e Departamentit për vitin 2023 e konkretisht:

Gjatë vitit 2022 Departamenti i Auditimit të Përformancës realizoi 15 auditime performance në 56 subjekte, kryesisht në fushën e arsimit, bujqësisë, mjedisit, përkujdeset social, infrastrukturës dhe transportit, zhvillimit ekonomik, reformave, duke gjeneruar 378 gjetje, 315 konkluzione dhe 369 rekomandime, ku ndër to vlen të përmendet se janë adresuar 17 rekomandime për përmirësime ligjore dhe 10 rekomandime për menaxhim jo efektiv fondesh. Nga pikëpamja e 3 E-ve, për vitin 2022 janë adresuar 303 gjetje, 259 konkluzione dhe 288 rekomandime për efektivitetin, 68 gjetje, 51 konkluzione dhe 54 rekomandime për eficiencën si dhe 7 gjetje e 5 konkluzione për ekonomikitetin.

Fokusi i auditimeve të performancës, sipas temave të kryera gjatë vitit 2022 ka përfshirë disa fusha me ndjeshmëri të lartë publike, si: fushën e arsimit dhe kulturës; fushën e bujqësisë; fushën e mjedisit; fushën e përkujdesit social; fushën e infrastrukturës & transportit; fushën e zhvillimit ekonomik kombëtar dhe fushën e reformave.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë planifikuar 3 dhe realizuar 5 auditime në institucionet të cilat kanë si objekt të punës së tyre menaxhimin e mjedisit, në lidhje me vlerësimin financiar të aktivitetit të tyre dhe përputhshmërisë me kriteret ligjore, në drejtim të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për menaxhimin ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, menaxhimin e kujdesshëm të burimeve të tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën. Gjithashtu në integrimin e politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, ndërgjegjësimin e popullatës, ndalimi gjuetisë paligjshme, monitorimin e kontrollin si dhe krijimin e përdorimin të ardhurave që realizon institucionit.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023.

- ✓ Realizimi i 16 auditimeve të performancës, 3 auditimeve “Përputhshmërie” dhe 2 auditime tematike mbi zbatimin e rekomandimeve;
- ✓ Përmirësimin të fokusit dhe problemit social apo kontekstit social;
- ✓ Përmirësimin i përcaktimit kriterëve të auditimit;
- ✓ Përmirësimi në vlerësimin e risqeve të aktivitetit të subjektit dhe i objektivit të auditimit;
- ✓ Përmirësimi i hartimit të pyetjes kryesore dhe nën pyetjeve në lidhje me kontekstin social;
- ✓ Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë raporteve të auditimit;
- ✓ Përmirësimi, pasurimi dhe aplikimi i metodologjive të reja audituese; (ngritur grup pune në departament)

- ✓ Shtimi dhe përdorimi si kriter i praktikave të mira ndërkombëtare përgjatë auditimit;
- ✓ Forcimi i kapaciteteve audituese nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të brendshme e jashtme; (ngritur grup pune në departament)
- ✓ Angazhim maksimal në bashkëpunimet me SAI-n e Norvegjisë, Suedisë ne auditimet “në proces”.

Në analizë e mori fjalën z. Bexhet Zeqiri, Drejtori i Drejtorisë e Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, i cili ndërmjet të tjerave vuri theksin në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së raporteve të auditimit e shkrimit të tyre, identifikimit të gjetjeve dhe përmirësimit të rekomandimeve.

